

V E N D I M
Nr.477, datë 14.10.1999

**PËR MIRATIMIN NË PARIM TË PROTOKOLLIT TË SESIONIT TË PARË TË
KOMISIONIT TË PËRBASHKËT NDËRQEVERITAR SHQIPTARO-KROAT PËR
BASHKËPUNIMIN EKONOMIK DHE TREGTAR DHE TË RREGULLORES SË PUNËS TË
KOMISIONIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I:

1. Miratimin në parim të Protokollit të bisedimeve të Sesionit të Parë të Komisionit të Përbashkët Ndërqeveritar Shqiptaro-Kroat për bashkëpunimin ekonomik dhe tregtar.
 2. Miratimin në parim të Rregullores së Punës të Komisionit të Përbashkët Ndërqeveritar Shqiptaro-Kroat për bashkëpunimin ekonomik dhe tregtar.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko